



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A – Prishtinë, Ad: " Luan Haradinaj", p.n.

Tel: 038/249-424, Fax: ++381(0)38/ 249-430.

e-mail.: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)

Në bazë të vendimit të Menaxhmentit, Ndërmarrja Publike Lokale PALLATI I RINISË SH.A., **shpallë:**

### **FTESE PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE**

Ftoheni që të oferoni për marrje në shfrytëzim me qira të lokalet afariste, zyre dhe depot të cilat janë pronë e **N.P.L PALLATI I RINISË SH.A.** Pronat e evidentuara me poshtë u jepen me qira personave juridik.

#### **Hapësirat afariste të cilat jepen me qira:**

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m <sup>2</sup> (pa TVSH)	Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m <sup>2</sup> (pa TVSH)
1.	Lokali nr. 42	67 m <sup>2</sup>	16.80 €	9.	Lokali nr. 62	20 m <sup>2</sup>	12.00 €
2.	Lokali nr. 43	33 m <sup>2</sup>	18.17 €	10.	Depo nr.02	54 m <sup>2</sup>	6.17€
3.	Lokali nr. 47	49 m <sup>2</sup>	16.80 €	11.	Depo nr.05	60 m <sup>2</sup>	6.17€
4.	Lokali nr. 51	64 m <sup>2</sup>	12.00 €	12.	Depo nr.08	60 m <sup>2</sup>	6.17€
5.	Lokali nr. 52	42 m <sup>2</sup>	12.00 €	13.	ZYRE nr. 116	39 m <sup>2</sup>	5.00€
6.	Lokali nr. 58	20 m <sup>2</sup>	12.00 €	14.			
7.	Lokali nr. 59	18 m <sup>2</sup>	12.00 €	15.			
8.	Lokali nr. 61	58 m <sup>2</sup>	12.00 €				

#### **Kushtet e Përgjithshme**

1. Periudha e qiradhënies është për 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi.
2. Qiramarrësi me anë të nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, është i obliguar që të bëjë parapagimin e një shumë monetare në vlerë të një qiraje mujore në llogari të Qiradhënësit.
3. Qiramarrësi është i obliguar që pas nënshkrimit të kontratës të bëjë sigurimin e mallit nga kompanitë e sigurimit.
4. Përveç çmimit fillestar, qiramarrësi do të paguaj plus shpenzimet tjera të parashikuara me kontratë (rrymë, pastrim, nxehje, ujë, kanalizim).
5. Këto lokale nuk janë të destinuar për hotelieri.

#### **Kriter për përzgjedhjen e ofertuesit me të favorshëm është:**

1. Çmimi me i lartë i ofertuar se sa çmimi fillestar.
2. Marrja me qira e krejt lokaleve.
3. Tarifa e aplikimit është 200.00 €, ku ofertuesit të zgjedhur, tarifa e aplikimit do ti kompensohet me faturën e parë të qirasë, ndërsa ofertuesit të zgjedhur i cili tërhiqet nga Kontrata për qira, nuk i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 € dhe ofertuesit të pazgjedhur i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 €, e cila do të paguhet në këtë Kont: **170802060000056.**

#### **Ofertuesi duhet t'i dorëzoi këto dokumente:**

1. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal (kopje)
2. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit; (kopje)
3. Çmimin e ofertuar për m<sup>2</sup> i cili duhet të jetë pa TVSH ( Ofertë)
4. Vërtetimin nga ATK-ja, që të dëshmohet se biznesi është aktiv;
5. Fletëpagesën për aplikim.

#### **Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:**

1. Ofertuesi i cili ka pasur lokal me qira në Pallatin e Rinisë dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
2. Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Nëse Oferta arrin pas datës së skadimit të afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuar në shpallje.

Personat juridik të cilët duan t'i vizitojnë lokalet, zyrat si dhe depot e lartcekura, mund t'a bëjnë, nga data: **21.09.2021**, deri me datën: **27.09.2021** nga ora **10<sup>00</sup>** deri në ora **15<sup>00</sup>**.

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur me datën: **28.09.2021** nga ora **10<sup>00</sup>** deri në orën **12<sup>00</sup>**, në zyrën e arhivës së qiradhënësit **N.P.L PALLATI I RINISË SH.A.** Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të specifikohet: emri i ofertuesit, nr i lokalit, zyrës ose depos dhe kontaktet, si: email-i zyrtar, dhe/apo nr. i telefonit .

Ofertat do të hapen nga ana e komisionit, me datë: **28.09.2021** nga ora: **12:30**, në prezencën e ofertuesve, në zyrën e Drejtorisë së Pallatit të Rinisë në Prishtinë. Kërkesa (aplikacioni) mund të kërkohet përmes email-it: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com) dhe në formë fizike në zyrën nr. 17, apo të shkarkohet nga faqja zyrtare e "Pallatit të Rinisë": [http://www.pallatirinise.com/.](http://www.pallatirinise.com/)